



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Njoftim për shtyp

Miratimi i Rezolutës

« Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017 »

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, mbledhur në seancë plenare, datë 03.05.2018 miratoi Rezolutën « Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017 ».

Rezoluta e Kuvendit, vlerëson rolin e Autoritetit të Konkurrencës, në funksion të mbrojtjes së konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, duke ndërhyrë në tregje me problematika të përsërta dhe sensitive të ekonomisë shqiptare, dhe që i shërben mbi gjithçka interesave të konsumatorit.

Rezoluta, parashtron përpara Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018, që veprimtaria e tij të ketë në fokus:

- Një bashkëpunim koherent me organet e administrates shtetërore dhe entet rregullatore, për të siguruar zbatimin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës;
- Monitorim në vazhdimësi të sjelljen e ndërmarrjeve që iu janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive dhe të veçanta, për të evidentuar dhe shmangur situata monopolistike;
- Bërjen efektive të vendimarrjes së Komisionit të Konkurrencës, në drejtin të ekzekutimit të vendimeve të këtij tij në vite.

Rezoluta, *veçanërisht* i kërkon Autoritetit të Konkurrencës, që të mbikëqyrë tregun e telefonisë celulare, që sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg, nuk sjell efekte antikonkurrese si dhe të monitorojë ndikimin e transaksionit pas transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication ShA tek sipërmarrësit Vodafone Albania ShA dhe Telekom Albania ShA në tregun e shitjes me pakicë dhe në konsumatorin fundor.